

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtaret Shqipe Qerimi Kryetare, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.G. nga fsh. ..., Komuna e Suharekës për shkak të veprave penale Sulmi nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 dhe veprës penale Kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.128/16 të datës 06.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.05.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.128/16 të datës 06.03.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, me aktgjykimin P.nr.128/16 të datës 06.03.2017, të akuzuarin B.G., e ka shpallur fajtor, për shkak të veprave penale Sulmi nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 dhe veprës penale Kanosje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe për veprën penale nën **I** të dispozitivit të aktgjyqimit ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër të re penale, në këtë dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.26.01.2016 deri me dt.09.02.2016, kurse për veprën penale nën **II** të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind)€, të cilin dënim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, konform nenit 46 par.3 të KPP-së, gjykata këtë dënim do ta zëvendësoi në dënim me burg, ku për 20€ do ti zëvendësoi me një ditë burg.

Të dëmtuarën e ka udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarin gjykata e ka obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokuroria Themelore në Prizren për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me burg efektiv i cili do të jetë në proporcion me peshën e veprës penale të kryer nga i akuzuari.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/II.nr.501/2017, të datës 24.04.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet në ankesë në ankesë gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari e ka pranuar fajësinë, prandaj, sipas nenit 383 par 2 të KPP, ndaj aktgjykimit që është marr në bazë të pranimin të fajësisë, ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve.

Përkitazi me shqiptimin e dënimin në ankesën e prokurorit pretendohet se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të lartësisë së dënimin, nuk i ka vlerësuar drejtë dispozitat ligjore mbi dënimin, po ashtu gjykata nuk i ka vlerësuar dhe konstatuar në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, në mënyrë të veçantë vetëm ka vlerësuar rrethanat lehtësuese e të cilat vetëm shprehimisht i ka potencuar, dhe duke pasur parasysh se këto vepra penale janë në rritje e sipër, me një dënim të këtillë nuk do të arrihet qëllimi i dënimin dhe të ndikoj te i akuzuari që sërish të mos kryej vepër të re penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimi i prokurorit për një dënim më të lartë është i pabazuar. Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimin siç parashihet në dispozitën e nenit 73 të KPK. Kështu, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori për bazë se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tersi të veprës së kryer, është penduar për veprën e kryer, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, kurse rrethana rënduese nuk gjeti.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimin e pranon edhe kjo gjykatë, prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, rrethanat e rastit konkret e posaçërisht duke

ia marr për bazë edhe pranimin e fajësisë, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, ku do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 478/2017, me dt.25.05.2017

Bashkë. prof
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. Rasim Rasimi

Shqipe Qerimi

2. Gani Zabeli